Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica - Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës
Nr. 01-020/04-0055453-2/26 **dt.** 28.09.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, neni 5 i Rregullores Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, Vendimi i Kuvendit Komunal me nr. 02-060/01-0042000-3/26 i datës 29.07.2026, në zbatim të pikës 5 të Vendimit të Kryetarit të Komunës me Nr. 01-400/04-0054346-2/26, dt. 11.09.2026 dhe pas shqyrtimit të Propozimit-Vendimit me Nr. 01-020/04-0055453/26, dt. 17.09.2026 nga Drejtoria për Mbrojtjen e Mjedisit, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

(Për formimin e Komisionit Vlerësues të konkursit komunal për kopshtin, ballkonin dhe sipërfaqen më të mirë të rregulluar para lokaleve afariste dhe atyre të gastronomisë)

1. **Formohet** Komisioni Vlerësues për konkursin komunal për kopshtin, ballkonin dhe sipërfaqen më të mirë të rregulluar para lokaleve afariste dhe atyre të gastronomisë në territorin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, në këtë përbërje:

   1.1. Bahri Sinani – kryesues (Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit);
   1.2. Irfan Peci – anëtar (Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit);
   1.3. Aferdita Maxhuni – anëtare (Sekretaria e Kuvendit Komunal);
   1.4. Hysnije Mikullovci – anëtare (Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural);
   1.5. Bedri Murati – anëtar (Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integrime Evropiane).

2. Komisioni Vlerësues i cili do të bëj vlerësimin e aplikacioneve dhe përzgjedhjen e fituesve në përputhje me kriteret e përcaktuara me Thirrjen Publike-Konkursin e shpallur për kopshtin, ballkonin dhe sipërfaqen më të mirë të rregulluar para lokaleve afariste dhe atyre të gastronomisë.

3. Komisioni Vlerësues obligohet që të shqyrtojë kërkesat në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh nga data e mbylljes së afatit për aplikim, dhe pas shqyrtimit të kërkesave obligohet që të përgatitë Rekomandim, e të njëjtin t'ia prezantojë Drejtorit të Drejtorisë për Mbrojtje të Mjedisit, i cili duke u bazuar në Raport-Rekomandimin e Komisionit, nxjerrë

Propozim-Vendim për Kryetarin e Komunës me qëllim të Vendim marrjes në lidhje me fituesit e konkursit.

4. Komisioni Vlerësues bazë për punën e tij do të ketë: Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Rregulloren Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, Vendimi i Kuvendit Komunal me nr. 02-060/01-0042000-3/26 i datës 29.07.2026, Thirrjen Publike-Konkursin e shpallur me datë 15.09.2026 dhe me nr. 14-400/04-0054966/26 dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.

5. Mandati i Komisionit Vlerësues i formuar sipas pikës 1 (një) të këtij Vendimi do të zgjas nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij Vendimi deri në përfundim të detyrave të përcaktuara me këtë Vendim.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryetari i Komunës

Faton PECI

Shtojcë:
1x1 Propozimit-Vendimit me Nr. 01-020/04-0055453/26, dt. 17.09.2026;
1x1 Vendimit të Kryetarit të Komunës me Nr. 01-400/04-0054346-2/26, dt. 11.09.2026;
1x1 Thirrjen Publike-Konkursin e shpallur me datë 15.09.2026 dhe me Nr. 14-400/04-0054966/26.

T'i dërgohet:
1x1 Kryetarit të Komunës
1x1 Zyrës Ligjore
1x1 Zyrës për Informim
1x1 Drejtorisë për Mbrojtje të Mjedisit
1x1 Anëtarëve të Komisionit Vlerësues
1x1 Arkivit